

FLISNI GJUHËN E PAQES!

Gjuha e urrejtjes
nuk është
opcion!



Financuar
nga Bashkimi Evropian
dhe Këshilli i Evropës



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Zbatohet
nga Këshilli i Evropës

**FLISNI GJUHËN E PAQES!
GJUHA E URREJTJES
NUK ËSHTË OPSION!**

© 2020 Këshilli i Evropës. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Licensuar sipas kushteve të Bashkimit Evropian. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të përkthehet, riprodhohet apo transmetohet, në asnjë formë dhe me asnjë mjet, elektronik (CDRom, Internet, etj.) apo mekanik, përfshirë fotokopjimin, regjistrimin apo çdo sistem tjetër të ruajtjes apo nxjerrjes së informacionit, pa lejen paraprake me shkrim nga Drejtoria e Komunikimeve (F-67075 Strasbourg Cedex ose publishing@coe.int).

FLISNI GJUHËN E PAQES!

Gjuha e urrejtjes
nuk është opSION!

Këshilli i Evropës

**SI DO TË NDJEHESHIT NËSE DIKUSH
PËRDOR URREJTJEN KUNDËR JUSH
APO KUNDËR NJERËZVE QË I DONI,
VETËM PËR SHKAK SE KUSH JENI?
A KA DIKUSH TË DREJTËN TË NA
DISKRIMINOJË DHE POSHTËROJË
PËR SHKAK SE KUSH JEMI? A NUK
DUHET TË TRAJTOHEMI TË GJITHË
ME RESPEKT?**



Kur njerëzit bëjnë thirrje për diskriminim apo dhunë kundër individëve apo grupeve për shkak të fesë apo besimeve të tyre, të ngjyrës së lëkurës, seksit, moshës, aftësisë së kufizuar, orientimit seksual, apo çdo karakteristike tjetër personale, kjo ka gjasa të jetë **gjuhë e urrejtjes.**




URREJTJA ËSHTË MË SHUMË SE SA 'THJESHT' FJALË: JASHTË INTERNETIT DHE NË TË!

Urrejtja mund të komunikohet në televizion, në gazeta, gjatë tubimeve publike, në shkollë, vendin e punës, apo në lagje, në rrugë ose brenda familjeve; ajo mund të shfaqet në internet nëpër uebfaqe, aplikacione, blogje, media sociale, ose në email apo biseda. Interneti mund të bëhet shumë armiqësor kur urrejtja shfaqet në video dhe fotografi, këngë, vizatime, imazhe të manipuluarra e kështu me radhë.

GJUHA E URREJTJES ËSHTË KËRCËNIM PËR TË DREJTAT E NJERIUT

*"Të gjitha qeniet njerëzore kanë lindur të lira dhe të barabarta në dinjitet dhe të drejta".
Neni 1 i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut*


E drejta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut garanton barazinë dhe mosdiskriminimin për të gjithë njerëzit. Mbrojtja e dinjitetit pa diskriminim është ajo që na mbron nga gjuha e urrejtjes. Kjo do të thotë se gjuha e urrejtjes është kërcënim për të drejtat e njeriut dhe në shumicën e vendeve format e rënda të gjuhës së urrejtjes janë të paligjshme.



ÇFARË ËSHTË DISKRIMINIMI?

Të gjithë njerëzit janë të barabartë në të drejtat e tyre. Diskriminimi është e kundërta e barazisë. Kur dikush trajtohet ndryshe pa ndonjë arsytim objektiv dhe të arsyeshëm, ky është diskriminim. Gjuha e urrejtjes shënjestron njerëzit si individë ose si grupe, për shkak se kush janë. Ajo armiqëson, marginalizon dhe çënon dinjitetin personal, shpeshherë të atyre që veçse janë të cënueshëm në shumë mënyra të tjera.

Mbani mend: Jo i gjithë diskriminimi shkaktohet nga gjuha e urrejtjes, por pothuajse e gjithë gjuha e urrejtjes bazohet në diskriminim, mbi supozimin se një person apo një grup personash janë superiorë ndaj të tjerëve.



LIRIA E SHPREHJES DHE GJUHA E URREJTJES

*"Ekziston një vijë e hollë ndarëse ndërmjet gjuhës së lirë dhe gjuhës së urrejtjes. Gjuha e lirë inkurajon debatin, ndërsa gjuha e urrejtjes nxit dhunën".
Njuton Li, Kundërterrorizmi dhe Siguria Kibernetike: Ndërgjegjësimi Total i Informacionit*

Kur themi liria e shprehjes, i referohemi faktit se që të gjithë kanë të drejtën të shprehen, të japin apo marrin lirshëm informacion dhe ide. Liria e shprehjes është e drejtë e njeriut, për shembull e përfshirë në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Kjo e drejtë është themel thelbësor i shoqërive demokratike dhe e rëndësishme për vetëpërbushjen e secilit individ.

Liria e shprehjes përfshin të drejtën për të shprehur ide që mund të konsiderohen si kritike, sulmuese, fyese apo kontraverse. Sidoqoftë, liria e shprehjes nuk është e drejtë pa kufi. Shtetet mund të sanksionojnë ose parandalojnë format e shprehjes që përhapin, nxisin, promovojnë ose arsyetojnë urrejtjen, për të mbrojtur të drejtat e njerëzve të tjerë. Duhet të ketë barazpeshë ndërmjet të lejuarit të njerëzve që të shprehin mendimet e tyre dhe të siguruarit se kjo gjë nuk çënon të drejtat e të tjerëve, apo të shkaktojë çrregullime apo krime.

URREJTJA NUK I PËRKET ASNJË GRUPI: ÇDOKUSH MUND TË JETË NË SHËNJESTËR TË GJUHËS SË URREJTJES!




“Pavarësisht nga cila pjesë e botës vijmë, që të gjithë në thelb jemi të njëjtat qenie njerëzore. Të gjithë kërkojmë lumturinë dhe përpiqemi t’i shmangemi vuajtjeve. Kemi të njëjtat nevoja bazë dhe preokupime njerëzore”.
Dalai Lama

Edhe pse çdokush mund të jetë në shënjestër të gjuhës së urrejtjes, në Evropë ekzistojnë disa grupe që shënjestrohen rregullisht, për shembull: LGBT-të, myslimanët, çifutët ose grupe të tjera fetare, gratë, emigrantët dhe minoritetet e tjera etnike, romët, njerëzit që jetojnë në varfëri, personat me aftësi të kufizuara etj. Grupet e shënjestruara dallojnë nga vendi në vend. Gjuha e urrejtjes ka pasoja të konsiderueshme dhe të mëdha mbi viktimën individuale, mbi grupin e shënjestruar dhe mbi grupet e tjera të cënueshme, por edhe mbi të gjithë komunitetin. Njerëzit mund të shënjestrohen edhe mbi bazën e më shumë se një karakteristike, për shembull si gra dhe si emigrante.

Të marrim një shembull. Pandemia e COVID-19 ka nxjerrë në pah një valë të re të gjuhës së urrejtjes, diskriminimit dhe stigmatizimit. Në fillim të pandemisë, individët që perceptoheshin si të etnisë kineze ose aziatike, emigrantët dhe të huajt, janë fajësuar për përhapjen e virusit. Gjithashtu, pandemia krijoi edhe grupe të reja të cënueshme: personat e infektuar me koronavirus iu ekspozuan përjashtimit social, izolimit, stigmatizimit dhe gjuhës së urrejtjes.



SHEMBUJ REALË TË PËRHAPJES SË GJUHËS SË URREJTJES QË U POPULLARIZUAN SHUMË NË MEDIA: INFLUENCESIT/ POLITIKANËT



Ta bësh të gjithë grupin e njerëzve të urrejnë, kërkon që t’i bindësh ata se një person apo grup njerëzish tjetër janë të ligj dhe të rrezikshëm.
Nga posteri „URREJTJA MODERNE“

Kur mendojmë për gjuhën e urrejtjes, duhet të mendojmë për ndikimin që ajo ka dhe për dëmin e saj tek individët, grupet apo shoqëria e tërë. Ky ndikim shumëfishohet në sferën publike, për shkak se figurat publike kanë ndikim mbi një audiencë të gjerë. Kjo është edhe arsyeja përse kanë përgjegjësi të shmangen nga përdorimi i gjuhës së urrejtjes dhe gjuhës stigmatizuese dhe të dënojnë përdorimin e gjuhës së urrejtjes nga të tjerët.

Çdo lloj i gjuhe urrejtjeje duhet të njihet si e keqe në një shkallë, ndërkohë që ka raste që mund të jenë shkallë edhe më të këqija. Për shembull, mund të jetë gjuhë më sulmuese, mund të prekë më shumë njerëz dhe mund të ketë më shumë potencial dëmtues, thjesht sepse është shprehur nga njerëz që kanë audiencë të gjerë në platformat e medias sociale. Këta njerëz mund ta përdorin gjuhën e urrejtjes dhe të krijojnë më shumë angazhim dhe të rrisin numrin e ndjekësve.

AKTIVITETI: NGA KEQ NË MË KEQ

Hidhuni nga një sy shembujve të mëposhtëm, a janë të njohur në kontekstin tuaj? A mund të mendoni disa shembuj të gjuhës së urrejtjes në vendin tuaj? Kush janë grupet e shënjestruara? Çfarë ndikimi ka gjuha e urrejtjes?

“Hitleri nuk vrau mjaft prej tyre!”

Deklaratë publike e një kryetari të bashkisë për popullatën rome në qytezën e tij.

“Nuk kanë çfarë të kontribuojnë, përveç dokumentimit të provuar të më shumë krimeve dhe përdhunimeve”.

Koment në një artikull në internet për krizën e refugjatëve të vitit 2015 në Evropë. 622 pëlqime dhe më shumë shikime.

“Homoseksualiteti, që është sëmundje e neveritshme, duhet të luftohet dhe të ndalohej”.

Nga një grup në Facebook me 300 anëtarë

“Askush nuk i ftoi çifutët në vendin tonë. E pra, pse duhet të na bëni të ndjehemi keq?”

Koment nën një postim blogu. Blogu shprehte trishtim për memorialin e vandalizuar të viktimave të Holokaustit.

“Gratë duhet të fitojnë më pak se sa burrat, sepse janë më të dobëta dhe jo aq inteligjente”.

Anëtar i Parlamentit Evropian



PËRSE ËSHTË E RËNDËSISHME TË LUFTOHET GJUHA E URREJTJES?

“Kam vendosur të ndjek dashurinë. Urrejtja është barrë shumë e rëndë për t’u bartur”. Martin Luter King, Jr


Përse duhet të veprimë në lidhje me gjuhën e urrejtjes?
Ja disa arsye:

- për të parandaluar shkelje të rënda të të drejtave të njeriut
- për të promovuar shoqëri paqësore, gjithëpërfshirëse, demokratike dhe të drejta
- për t’i kontribuar luftës ndaj dhunës kundër grave
- për të parandaluar konfliktet e armatosura, mizoritë dhe krimet e tjera.

Gjuha e urrejtjes duhet të adresohet jo vetëm kur shfaqet, por edhe në rrënjët e saj. Me fjalë të tjera, në nivelin e qëndrimeve dhe marrëdhënieve ndërmjet grupeve të ndryshme në shoqëri. Urrejtja lulëzon mbi qëndrimet raciste, seksizmin dhe stereotipet. Nëse nuk kundërshtohet, ajo ushqen shoqërinë, duke përforcuar stereotipet dhe duke i rritur më shumë gjasat për abuzim, përfshirë në disa raste, edhe dhunën fizike. Në këtë rast të fundit, gjuha e urrejtjes mund të shndërrohet në krim të urrejtjes. Shkeljeve masive të të drejtave të njeriut, si gjenocidi dhe spastrimi etnik, u paraprin gjuha e urrejtjes.

AKTIVITET: KU NA ÇON GJUHA E URREJTJES?

Ndonjëherë përdoret piramida e urrejtjes për të shpjeguar pasojat e gjuhës së urrejtjes dhe përse është e nevojshme të rregullohen format e saj të ndryshme, për të mbështetur vlerat demokratike dhe për të parandaluar dhunën. Mendoni për kontekstin tuaj: a njihni ndonjë nga format e gjuhës së urrejtjes nga kjo piramidë?




Burimi: Lidhja Antishpifje

MBANI QËNDRIM NDAJ GJUHËS SË URREJTJES

„Po sikur të mos e shohim veten në bazë të dukjes, fesë që praktikojmë, apo ku jetojmë... por në bazë të asaj që vlerësojmë? Njerëzia, mirësia, ndjesia e brendshme e lidhjes ndërmjet nesh. Dhe besimi se ne jemi kujdestarët jo vetëm të shtëpisë dhe planetit tonë, por edhe kujdestarë të njëri-tjetrit”.


Xhasinda Ardern, Kryeministrja e Zelandës së Re



Të gjithë mund të mbajnë qëndrim ndaj urrejtjes, ta shohim se si.

Të luftosh gjuhën e urrejtjes me dashuri e empati, dhembshuri dhe fuqi, mund të mos e eliminojë atë tërësisht, por sa më shumë hapa që ndërmarrim për të edukuar dhe mbështetur qeniet njerëzore dhe të flasim hapur kundër padrejtësive, aq më e mirë bëhet kjo botë. Nëse bashkarisht reagojmë ndaj gjuhës së urrejtjes, ajo nuk bëhet normë!

MË TË FORTË SË BASHKU PËR TË LUFTUAR GJUHËN E URREJTJES



Disa njerëz e parandalojnë urrejtjen, sepse u ndihmojnë komuniteteve të bashkohen, të njihen më mirë me njëri-tjetrin dhe të jetojnë bashkërisht mbi bazën e respektit. Të tjerët reagojnë ndaj gjuhës së urrejtjes duke dhënë kundërgjykimet. Të tjerë edukojnë të rinjtë që të sillen me respekt ndaj dallimeve. Disa njerëz shfaqin solidaritet dhe mbështesin grupet e sulmuara. Të tjerët flasin kundër padrejtësive me kundërnarrativa. Disa organizata e monitorojnë gjuhën e urrejtjes. Disa njerëz i paraqesin në gjykatë rastet e gjuhës së urrejtjes. Disa institucione mund të vënë gjykatë ndaj stacioneve televizive që përhapin gjuhën e urrejtjes, e madje edhe ndaj medias sociale. Të gjithë këta shembuj tregojnë se shpesh ka veprime që njerëzit mund të ndër marrin kundër gjuhës së urrejtjes, edhe para se ajo të ndodhë!


Për ta kundërshtuar gjuhën e urrejtjes, të gjithë duhet të punojmë bashkarisht: politikëbërësit, shoqëria civile, ata që përfshihen në arsim, media, feja dhe besimi, sektorët e rinisë, policia, e kështu me radhë.

Shpeshherë, shoqëria civile është gjendur në vijën e parë të frontit për dallimin e shenjave të para të dhe të luftës kundër të gjitha formave të intolerancës dhe diskriminimit. Shoqëria civile:

- **avokon që qeveritë të adresojnë gjuhën e urrejtjes, për shembull duke përmirësuar ligjet**
- **raporton gjuhën e urrejtjes**
- **vepron si zëri i viktimave dhe u ofron atyre këshilla ligjore ose këshillim**
- **edukon, rrit ndërgjegjësimin dhe bën fushata për veprime që luftojnë gjuhën e urrejtjes.**

REAGIMI NDAJ URREJTJES

“Ne mund të mos pajtohemi dhe sërish ta duam njëri-tjetrin, vetëm nëse mospajtimi është i rrënjësor në shtypjen time dhe në mohimin e humanitetit tim dhe të së drejtës sime për të ekzistuar”. Xhejms Balduin



Duhet të kemi parasysh se të drejtat e njeriut janë universale, të pandashme, të ndërlidhura, të ndërvarura dhe të domosdoshme për të gjitha qeniet njerëzore, edhe për ata që promovojnë gjuhën e urrejtjes! Gjithashtu ndodh që njerëzit të thonë gjëra, sidomos në internet, pa i peshuar ato mirë ose duke shkaktuar fyerje pa e patur për qëllim dhe më pas pendohen, ndoshta edhe i tërheqin mbrapsht fjalët e tyre. Mirëpo në raste të tjera, gjuha e urrejtjes shpërmdahet me dëshirë si për shembull si pjesë e fushatave të urrejtjes.

Duhet të kemi parasysh se çdo reagim ndaj gjuhës së urrejtjes duhet të pranojë se ‘urrejtja’ bie brenda një spektri. Kjo do të thotë se, edhe pse të gjithë shprehjet e urrejtjes mund të jenë të këqia në një shkallë të caktuar, një rast mundet të jetë më i keq se një tjetër (më sulmues, prek më shumë njerëz, është më nxitës, ka më shumë potencial për dëm, etj). Reagimet ndaj gjuhës së urrejtjes duhet të marrin parasysh dallimet në shkallën e urrejtjes së shprehur.

Në të njëjtën kohë, kur adresojmë gjuhën e urrejtjes, duhet të sigurohemi se argumentat tanë nuk zvogëlojnë të drejtat e njeriut të dikujt tjetër dhe nuk i dehumanizojnë të tjerët! Reagimi ndaj urrejtjes me urrejtje nuk e zgjidh problemin.

10 STRATEGJI QË NDIHMOJNË LUFTËN KUNDËR GJUHËS SË URREJTJES NË JETËN E PËRDITSHME

“Ne të gjithë lindim me kapacitetin për agresion dhe për dhembshuri. Se cilën tendencë përqafojmë, kërkon zgjedhje të ndërgjegjshme nga individët, familjet, komunitetet dhe kultura jonë në përgjithësi. Çelësi për të tejkaluar urrejtjen është edukimi: në shtëpi, në shkolla dhe në komunitet”.
Psikologu Bernard Golden

• MBANI QËNDRIM DHE BËJENI TË QARTË SE NUK PAJTOHENI:

tregoni se ka njerëz që nuk i tolerojnë deklaratat tilla. Të rritsh i heshtur mund të nënkutpojnë se pajtoheni me ta dhe kështu, urrejtja vazhdon të përhapet... Sidomos nëse e njihni personin që ka përdorur gjuhën e urrejtjes, gjithnjë mund ta pyesni pse dikush duhet të thotë gjëra të tilla. Kur bën pyetje e detyronin personin të mendojë për deklaratat e veta.

• **PËRDORNI GJUHË JOSULMUESE KUR REAGONI DHE MOS REAGONI NË TË NJËJTËN MËNYRË SI TONI I MESAZHIT FILLESTAR URREJTËS:** pavarësisht sa shumë mund ta dëshironi, mos u hakmerrni apo mos reagoni në mënyrë jo të duhur, edhe nëse situata është veçanërisht e dhimbshme. Mos e shënjestroni autorin, por përmbajtjen e deklaratës!

• **TREGONI EMPATI NDAJ ATYRE QË SHËNJESTROHEN NGA GJUHA E URREJTJES:** tregoni se ju mendoni që gjuha e urrejtjes është e vrazhdë dhe fyese. Përveçse të tregoni mbështetje për viktimën, mesazhi juaj mund ta inkurajojë viktimën të kuptojë se nuk ka nevojë ta pranojë urrejtjen dhe ta raportojë tek autoritetet.

Çfarë mund të bëni kur sapo keni hasur në mesazh urrejtës? Cilat strategji funksionojnë dhe cilat jo? Si reagoni? Hidhuni nga një sy këtyre hapave të dobishëm më poshtë!

• **KORRIGJONI INFORMATAT E RREME:**

sa herë që keni hapësirë për të shtuar informacion të saktë, bëjeni këtë dhe dëshmohuni me fakte pretendimet e rreme! Mund të mos e bindni urrejtësin, por mund t'i bindni lexuesit dhe dëgjuesit.

• **LARGOJENI NËSE ËSHTË E NEVOJSHME:**

pavarësisht a preferoni të përgjigjeni direkt ose jo, mundeni gjithnjë të raportoni përmbajtjen në internet si gjuhë të urrejtjes apo ta largoni postimin, sidomos në murin apo faqen tuaj. Raportojeni tek platforma në internet (media sociale, forume). Nëse nuk kanë njohuri për të, nuk mund të bëjnë dot gjë. Shmangni ripostimin, pasi kështu e popullarizoni më shumë mesazhin urrejtës dhe e bëni më të dukshëm.

• **MOS HUMBNI KOHË NË DISKUTIME TË PAFUND:**

shprehni mosbesimin dhe pakënaqësinë tuaj dhe qëndroni pranë deklaratave të qeta. Shkruani shkurt, por fuqishëm.

• **MËSONI DHE FLISNI PËR DIVERSITETIN, BARAZINË, GJITHËPËRFSHIRJEN:**

sa më shumë njerëz të edukohen për këto çështje, aq më shumë mund ta parandalojmë gjuhën e urrejtjes.

• **DILNI VULLNETARË PËR TË DREJTAT E NJERIUT DHE TREGOHUNI PROAKTIVË:**

bëhuni pjesë e komuniteteve ose organizatave që promovojnë të drejtat e njeriut. Kontrolloni në kontekstin tuaj nëse ka organizata që punojnë, për shembull, për gjithëpërfshirje, vlera demokratike dhe paqe ose kundër racizmit, seksizmit dhe diskriminimit, dhe bashkohuni në përpjekjet e tyre.

• **RAPORTOJENI GJUHËN E URREJTJES TEK AUTORITETET:**

në rast se asnjë nga këta hapa nuk ndihmon dhe ju ndjeheni se ju kërcënohet siguria dhe jeta, raportojeni gjuhën e urrejtjes tek autoritetet.

• **MOS HUMBISNI SHPRESAT:**

rrënjët e urrejtjes janë të thella dhe të fuqishme dhe pavarësisht sa përpiqeni, rreziku për gjuhën e urrejtjes ekziston. Ajo çka është me rëndësi është që të veproni dhe të bashkoheni me të tjerë që punojnë për të njëjtën kauzë.

”

”

”

ÇFARË BËN KËSHILLI I EVROPËS PËR GJUHËN E URREJTJES

**“Qëllimi i Këshillit të Evropës është të arrijë bashkim më të madh ndërmjet anëtarëve të vet...”
Neni 1, Statuti i Këshillit të Evropës**

I themeluar në vitin 1949, Këshilli i Evropës ka 47 shtete anëtare. Ai promovon parimet e përbashkëta dhe demokratike në bazë të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe konventave dhe dokumentave të tjerë për të drejtat e njeriut.

Kur është fjala tek gjuha e urrejtjes, Këshilli i Evropës:

- ka miratuar standardet për të drejtat e njeriut dhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut është marrë me disa raste të gjuhës së urrejtjes, duke krijuar jurisprudencë për këtë temë që është e vlefshme për të gjitha vendet anëtare.
- organet e veta të ndryshme kanë miratuar rekomandime dhe udhëzues për t’iu ardhur në ndihmë vendeve që të merren me gjuhën e urrejtjes dhe t’i ndihmojnë viktimat; ka miratuar përkufizimin e gjuhës së urrejtjes që në vitin 1997.
- monitoron problemet e racizmit, ksenofobisë, antisemitizmit, intolerancës dhe diskriminimit në shtetet anëtare, përmes punës së monitoruesve të [Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës \(ECRI\)](#). ECRI ka sjellë [Rekomandimin Nr. 15 mbi Luftën kundër Gjuhës së Urrejtjes](#) të Politikave të Përgjithshme që u jep shteteve anëtare udhëzues se si ta kundërshtojnë këtë problem.
- mbështet zhvillimin e politikave dhe siguron trajnim për institucionet vendore dhe shoqërinë civile që të luftojnë gjuhën e urrejtjes, për shembull përmes punës së [Njesisë së Bashkëpunimit Kundër Gjuhës së Urrejtjes](#)
- organizon fushata dhe aktivitete edukuese për të luftuar gjuhën e urrejtjes, si [Fushata rinore Lëvizja Jo Gjuhës së Urrejtjes](#)

Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës, përmes programeve të tyre të përbashkëta të bashkëpunimit si Partneriteti për Qeverisje të Mirë dhe Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë, ofrojnë ndihmë për përfituesit në sjelljen e reformave përpara në luftimin e diskriminimit dhe gjuhës së urrejtjes; në rritjen e kapaciteteve institucionale dhe dëmshpërblimi për viktimat, si dhe rritjen e ndërgjegjësimit të publikut të gjerë mbi këtë temë.

- zhvillon doracakë edukativë, “Librashenjues” dhe “NE MUNDEMI”, për t’i mbështetur edukatorët që të eksplorojnë dhe luftojnë gjuhën e urrejtjes tek të rinjtë përmes edukimit për të drejtat e njeriut dhe të kundërshtojnë narrativat alternative
- punon për ta luftuar diskriminimin në shumë kënde, si [arsimi](#), [sporti](#), [të drejtat e romëve](#), [barazia gjinore](#), [orientimi seksual dhe identiteti gjinor](#), [media dhe qeverisja në internet](#), [punësimi](#), [lufta kundër gjuhës së urrejtjes seksiste](#), e kështu me radhë.

[Fushata rinore Lëvizja Jo Gjuhës së Urrejtjes e Këshillit të Evropës](#) ishte fushatë mbarë evropiane gjatë së cilës shumë njerëz dhe organizata bënë aktivitete edukative për të rinjtë që të luftojnë gjuhën e urrejtjes dhe të promovojnë të drejtat e njeriut në internet, organizuan diskutime me aktivistë për të drejtat e njeriut se si të luftohet urrejtja, raportuan gjuhën e urrejtjes tek media sociale apo autoritetet dhe organizuan veprime tematike në internet për t’i informuar njerëzit lidhur me grupet që shënjestrohen nga gjuha e urrejtjes. Shumë organizata të përfshira në këtë fushatë e vazhduan punën e tyre, si për shembull Rrjeti kundër Gjuhës së Urrejtjes.

Jeni në kërkim të frymëzimit se si ta luftoni gjuhën e urrejtjes? Hidhuni nga një sy shembujve në vijim www.coe.int/en/web/no-hate-campaign

Linqe të dobishme:

Uebfaqja e Këshillit të Evropës: www.coe.int

Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës: www.coe.int/ecri

Divizioni për Gjithpërfshirje dhe Antidiskriminim i Këshillit të Evropës: www.coe.int/en/inclusion-and-antidiscrimination

Kjo broshurë shqyrton konceptet e gjuhës së urrejtjes, manifestimet e saj, rreziqet e saj për të drejtat e njeriut dhe demokracitë. Kjo broshurë u krijua për çdo person dhe gjithashtu për organizatat e shoqërisë civile dhe të tjerë që ndiejnë nevojën për të kuptuar më mirë fenomenin e gjuhës së urrejtjes dhe dëshirojnë të bëjnë diçka për të luftuar gjuhën e urrejtjes. Broshurat japin shpjegime rreth gjuhës së urrejtjes si dhe propozime për veprime për të parandaluar dhe luftuar gjuhën e urrejtjes.



Kjo broshurë u zhvillua si pjesë e programeve të përbashkëta të financuara nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës, Partneriteti për Qeverisje të Mirë (PGG) dhe Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë (HF); në veçanti projekti „Promovimi i diversitetit dhe barazisë në Ballkanin Perëndimor“ (HF) dhe projekti „Forcimi i aksesit në drejtësi përmes mekanizmave jo-gjyqësorë të dëmshpërblimit për viktimat e diskriminimit, gjuhës së urrejtjes dhe krimeve të urrejtjes në Partneritetin Lindor“ (PGG) . Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të konsiderohen në asnjë mënyrë se pasqyrojnë mendimin zyrtar të secilës palë.

Këshilli i Evropës është organizata kryesore për të drejtat e njeriut në kontinent. Ai përbëhet nga 47 shtete anëtare, përfshirë të gjithë pjesëtarët e Bashkimit Evropian. Të gjithë anëtarët e Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, një traktat i dizajnuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe sundimin e ligjit. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut mbikëqyr zbatimin e Konventës në shtetet anëtare.

www.coe.int

The Member States of the European Union have decided to link together their know-how, resources and destinies. Together, they have built a zone of stability, democracy and sustainable development whilst maintaining cultural diversity, tolerance and individual freedoms. The European Union is committed to sharing its achievements and its values with countries and peoples beyond its borders.

www.europa.eu

Financuar
nga Bashkimi Evropian
dhe Këshilli i Evropës



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Zbatohet
nga Këshilli i Evropës